



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Nr. 750/3 prot.

Kukës, më 17.9.2025

L E N D A :

Verifikimi i Ligjshmërisë së Aktit.
KRYETARIT TË BASHKISË

KËSHILLIT BASHKIAK

T R O P O J Ë

Në protokollin e Prefektit të Qarkut Kukës është regjistruar vendimi i këshillit bashkiak Tropojë me nr.3562/5 prot., datë 10.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 750 prot., datë 11.09.2025. Bazuar në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (i ndryshuar) neni 16, shqyrtuam vendimin e Këshillit Bashkiak Tropojë të miratuar në mbledhjen e datës 04.09.2025 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimin si më poshtë:

Vendimi Nr.49 datë 04.09.2025 i Këshillit Bashkiak Tropojë “Për miratimin e planit social të rishikuar të bashkisë Tropojë për periudhën 2025-2027”, është në përputhje me ligjin nr.139/2015, datë 17. 12. 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) nenet 3, 8/2, 24, 54/k; ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nenet 4, 6, 26, 27, 36, 37, 46, 47; ligjin 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjin 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar); ligjin 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”; ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; ligjin Nr.22/2018, dt. 03. 05. 2018 “Për strehimin social”, (i ndryshuar); VKM nr. 111, datë 23. 02. 2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”, VKM-në 152 datë 13.03.2024 „Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

PREFEKTI
Dritan Baji

